



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:261978

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06893893

KPPP.nr.813/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbare të kreditorit “EuroSig” SH.A., me seli në Prishtinë, rr. “2 Korriku”, kundër debitorit “EuroMed Group d.o.o”, SH.P.K., me seli në Prishtinë, rr. ”Nëna Terezë”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.845/19 të datës 13.11.2019, të Përmbareusit Privat Afet Mjeku, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 24.02.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi i pa bazuar prapësimi i debitorit “EuroMed Group d.o.o”, SH.P.K., dhe Urdhri Përmbare P.nr.845/19 i lejuar me datë 13.11.2019, nga Përmbareusi Privat Kushtrim M. Musa, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbareusi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, “EuroSig” SH.A., ka lëshuar urdhrin përmbare, P.nr.845/19 të datës 13.11.2019 me të cilin ka lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit të besueshëm të Faturës Nr.018223 të datës 23.06.2017 në shumë prej 826€, me të cilin ka obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të Urdhrit, t’ia kthej kreditorit në emër të obligimeve të papaguara shumë prej 826€ euro si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbare, aq sa ato të krijohen sipas llogarisë së organit përmbareus, në pajtim me U.A. – MD Nr.06/2014, nën kërcënim të përmbareimit të dhunshëm

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbare për shkak se nuk e ka shfrytëzuar asnjëherë polisën e sigurimit.

Kreditori në përgjigjen e prapësimit të paraqitur brenda afatit ligjor, thekson se sigurimi kasko është sigurim vullnetarë dhe jo sigurim i detyrueshëm dhe se i njëjti nuk bëhet që detyrimisht të

shfrytëzohet por me të sigurohet një ngjarje që potencialisht mund të ndodhë. Tutje thekson se debitori ka pranuar se ka qenë në marrëdhënie kontraktuale por që me vetëdije thotë se nuk do ta paguaj borxhin. Andaj nga gjykata kërkon që të refuzon prapësimin e debitorit dhe ta vërtetoj urdhrin përmbarimor si të bazuar.

Lidhur me këtë çështje përmbarimore fillimisht ishte vendosur nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm- Divizion Civil, përmes Aktvendimit PPP.nr.554/20, të datës 18.06.2021, ishte aprovuar prapësimi i debitorit dhe ishte shfuqizuar urdhri përmbarimor.

Duke vepruar sipas ankesës së kreditorit, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.694/2023 kishte aprovuar ankesën e kreditorit dhe çështjen e kishte kthyer në rivendosje, me rekomandimin që të vërtetohet se fatura e pranuar nga debitori përbën dokument të besueshëm dhe se a ka tipare të përmbarueshmërisë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, rekomandimeve të dhëna nga Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 lidhur me nenin 71 par. 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se prapësimi i debitorit nuk është i bazuar andaj e refuzoi si të tillë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 të LPP-së, *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa, në pikën 1.3 të të njëjtit nen, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.* Tutje, me paragrafin 3 të nenit 29 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “. Në anën tjetër, neni 37 i LPP-së, përcakton se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.*

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – përkatësisht Faturën Nr.018223 të datës 23.06.2017, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e

debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Gjithashtu, fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, janë paraqitur në kopje të vërtetuar dhe se pranimi i të njëjtave nuk kundërshtohet nga debitori në prapësimin e tij.

Gjykata pretendimet e debitorit se polisa e sigurimit nuk është përdorur, nuk i mori si të bazuara pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se Fatura Nr.018223 e datës 23.06.2017, është origjinale dhe e nënshkruar nga debitori, andaj e njëjta është e rregullt në kuptim të nenit 38 të LPP-së i cili përcakton se *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.”*.

Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore të përcaktuara në nenin 71 të LPP-së, mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.813/24, datë 24.02.2025

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.